

Doracak për
çlirimin e gruas
~ edicioni i Kosovës ~

Emri i publikimit:

Doracak për çlirimin e gruas - edicioni i Kosovës

Botuesi:

Qendra për Veprime Afirmative Sociale - CASA

Autor:

Dušica Jovičić

Redaktor:

Boban Simić

Konsulente për çështjet gjinore:

Nora Ahmetaj

Përkthimi:

Srđan Simonović IB

Redaktori:

Tomislav Perušić

Dizajni:

Bojan Marinković

Printimi:

CAP Solution

Viti i botimit: maj 2024.

Mohim i përgjegjësisë: Ky publikim është krijuar si pjesë e projektit të Qendrës Barabar me mbështetjen financiare të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Autorët e publikimit janë përgjegjës vetëm për pikëpamjet e shprehura në këtë dokument dhe në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë pikëpamjet zyrtare të UNMIK-ut.

PËRMBAJTJA

Rreth Klubit të Emancipimit	3
Metodologjia e punëtorisë	3
Përmbledhje.....	3
Parimet e Klubit të Emancipimit	5
Moskonsistenca e brendshme e patriarkatit.....	7
Femrat dhe gjinia.....	10
Socializimi gjinor.....	11
Si të kapërcejmë stereotipet gjinore?	13
Gratë udhëheqin	15
Gratë dhe feminizmi	16
Gratë dhe politika	18
Si të kemi më shumë gra në pozita udhëheqëse?.....	20
Gratë dhe konflikti	21
Perspektiva e grave në zgjidhjen e konflikteve	22
Si t'u mundësojmë grave që të jenë pjesë e proceseve të paqes?	23
Gratë dhe mediat	24
Prezantimi stereotipik i grave	25
Si të tejkalohen këto probleme?	27
Në gjurmët e konkluzionit	27
Literatura.....	29

Rreth Klubit të Emancipimit

Klubi ynë i Emancipimit filloi punën në shkurt të vitit 2024 në Qendrën Barabar në Prishtinë. Ideja themelore ishte t'u mundësohej vajzave të reja nga Kosova të fitonin një ide për rëndësinë e identitetit gjinor përmes punëtorive të dizajnuara në mënyrë tematike, dhe për rrjedhojë edhe për mundësitë e ndërtimit të solidaritetit, tolerancës dhe pajtimit bazuar në të. Kështu është dizajnuar qëllimi kryesor i Klubit - fuqizimi i grave të reja, përmes çlirimit të tyre dhe kuptimit më të mirë të pozitës së tyre në shoqëri, e që tejkalon dallimet kulturore, fetare dhe etnike.

Në kuadër të Klubit tonë të Grave janë mbajtur katër punëtori tematike me titull: *Gratë si agjente të ndryshimit, Aktivizmi i grave, lidershipi dhe vullnetarizmi, Zgjidhja e konflikteve dhe Gratë në media*. Secila prej tyre është konceptuar si një njësi tematike më vete, por gjithmonë e lidhur me temën e gjinisë.

Ne mundëm të shikonim në kohë reale se si u realizua qëllimi ynë: në hapësirën e sigurt të Qendrës Barabar, vajzat e reja verbalizuan përvoja të njëjta dhe evidentuan probleme të ngjajshme. ***I vetmi dallim ishte se ato përdornin gjuhë të ndryshme.*** Kjo na çoi në përfundimin se komunikimi ndërmjet komuniteteve është parakusht i domosdoshëm për fuqizimin e të gjitha grave në Kosovë.

Metodologjia e punëtorisë

Punëtoritë janë mbajtur në dy blloqe me nga dy punëtori gjatë shkurtit dhe marsit. Pjesëmarrëset ishin të reja nga Kosova të moshës 18 deri në 29 vjeç, nxënëse, studente, gra që punojnë. Ajo që i bëri bashkë ishte entuziazmi që treguan për qëllimet dhe vetë idenë e Klubit të Emancipimit. Punëtoritë u drejtuan nga gra që kanë përvojë praktike profesionale dhe afatgjatë dhe punëtoritë kishin karakter ndërveprues, gjë që bëri të mundur gjallërimin e materialit dhe afrimin e tij me pjesëmarrësit.

Përmbledhje

Ky manifest ose thënë më mirë doracak për çlirimin e gruas në Kosovë është një manifestim i prekshëm i Klubit të Emancipimit. Duke lexuar, ju mund të fitoni një kuptim më të thellë të temave që kemi trajtuar në punëtoritë brenda Klubit.

I Gratë dhe gjinia

Kjo pjesë fokusohet në çështjet e gjinisë dhe socializimit gjinor. Ne e dimë se ka dallime biologjike midis grave dhe burrave. Socializimi gjinor është një proces që krijon dallime sociale bazuar në këto dallime, duke formuar role gjinore. Ato reflektohen në pritshmëritë dhe liritë që kanë djemtë dhe vajzat. Ky proces shpesh inkurajon stereotipat dhe kufizon liritë individuale, veçanërisht në komunitetet thellësisht tradicionale dhe patriarkale si ajo e Kosovës.

II Gratë udhëheqin

Gratë në Kosovë vijnë nga komunitete të ndryshme, por kanë nevojë të përbashkët për feminizmin si ide dhe praktikë e çlirimit të gruas. Kjo pjesë tregon evolucionin e feminizmit përmes valëve dhe hedh dritë mbi rolin e tij në fuqizimin e grave, duke nxjerrë në pah valët e ndryshme të luftës dhe sfidave me të cilat përballen gratë në politikë, si një sferë dominuese mashkullore.

III Gratë dhe proceset paqësore

Kjo pjesë do të diskutojë perspektivën e grave në zgjidhjen dhe rezoluten 1325. Edhe pse shpeshherë neglizhohen, gratë nga zonat e prekura nga lufta mund të japin një kontribut të vlefshëm në procesin e ndërtimit të paqes, siç dëshmohet nga përpjekjet e aktivistëve të shumtë nga Serbia dhe Kosova gjatë dhe pas luftës në Kosovë në vitin 1999.

IV Gratë në media

Në pjesën e fundit të manifestit do të shikojmë se si prezantohen gratë në media, ku përballen me stereotipe dhe standarde të dyfishta. Përveç kësaj, do të shikojmë edhe çështjen e pabarazisë gjinore në mediat serbe dhe shqiptare.

Ky doracak është i dedikuar për të gjitha të rejtat në Kosovë që janë në rrugën e emancipimit dhe që kuptojnë se solidariteti i grave i kapërcen kufijtë politikë, gjeografikë dhe kulturorë. Megjithatë, mund të lexohet nga kushdo, kurioziteti i të cilit/cilës duhet të kënaqet kur bëhet fjalë për temat e emancipimit. Manifesti mund të lexohet si tërësi, mund të lexohet sipas fushës. Ai ka dy synime kryesore: të ofrojë një kuptim dhe pasqyrë më të thellë të pozitës së gruas në Kosovë sot, dhe të promovojë bashkëpunimin ndëretnik dhe bashkimin e grave në Kosovë përmes temave kryesore rreth temave, çështjeve dhe problemeve që janë të përbashkëta për to.

Parimet e Klubit të Emancipimit

Ky dokument bazohet në disa parime që shërbejnë si bazë për arritjen e qëllimeve të Klubit. Ato janë:

1. Parimi i të mësuarit për gjininë:

Cjnia është një konstrukt sociologjik i formësuar nga normat kulturore. Rolet gjinore, stereotipet dhe paragjykimet janë sjellje të mësuara që përjetësojnë pabarazinë. **Dëshira për një jetë më të drejtë në Kosovë na obligon të kuptojmë dhe të luftojmë ndaj normave dhe stereotipave të dëmshme të bazuara në gjini.**

2. Parimi i çmitizimit të feminitetit:

Të jesh grua në Kosovë nënkupton një sërë paragjykimesh dhe pritjesh sociale. Ato janë padyshim një barrë. **Rruga drejt një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe progresive në Kosovë fillon me fuqizimin e grave për të dalë nga kornizat tradicionale dhe për të pranuar role atipike.**

3. Parimi i emancipimit politik të gruas:

Gratë luajnë një rol kyç në formësimin e së ardhmes së peizazhit politik të Kosovës. Kontributi i gruas në jetën politike në Kosovë duhet të njihet si vlerë e shtuar. **Progresi shoqëror dhe transformimi janë të mundur vetëm përmes pjesëmarrjes më të fortë të grave në vendet ku merren vendime të rëndësishme politike.**

4. Parimi i menaxhimit gjithëpërfshirës gjinor:

Progresi shoqëror dhe transformimi janë të mundur vetëm përmes pjesëmarrjes më të fortë të grave në vendet ku merren vendime të rëndësishme politike.

5. Parimi i vlefshmërisë së perspektivës së grave në proceset paqesore:

Veçantia e përvojave dhe njohurive të grave kontribuon në marrëveshje paqeje më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

6. Parimi i gjithëpërfshirjes në ndërtimin e paqes:


Përprojekjet për ndërtimin e paqes në Kosovë duhet të jenë përpjekje të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse gjinore.

7. Parimi i autenticitetit në media:

Prezantimi real i grave në media, i lirë nga stereotipat dhe imazhet e idealizuara, me mirëkuptim dhe respekt për kompleksitetin e grave, është imperativ për të gjitha mediat.

8. Parimi i barazisë gjinore në media:

Trajtimi i drejtë i grave në media, si dhe i atyre grave që punojnë në media, është i nevojshëm për të ndaluar standardet e dyfishta, paragjykimet dhe pabarazinë gjinore.

The background features a light cream color with intricate marbled patterns in shades of gold and brown. The corners are adorned with delicate floral illustrations, including blue and pink flowers with green leaves and small blue berries.

***Moskonsistencat e
brendshme të patriarkatit***

Në çdo tregim për luftën e grave për të drejta, ne duhet të nisemi nga patriarkati. Patriarkati në kuptim fjalë për fjalë do të thotë **sundimi i babait** dhe përshkruhet si një formë e organizimit shoqëror të dominuar nga burrat. Patriarkati është një sistem në të cilin burrat vendosin dhe ku vlerat e tyre janë dominuese. Është e rëndësishme të kuptohet se çdo sistem që kontribuon në supremacinë sociale, kulturore, politike dhe ekonomike të burrave është në thelb patriarkal. Kjo është e rëndësishme sepse e gjithë bota në vitin 2024 është ende patriarkale. Kosova nuk ndryshon nga pjesa tjetër e botës. Në Kosovë sot gratë kryejnë pjesën më të madhe të punëve të shtëpisë, martesat dhe familja konsiderohen si gjëja më e rëndësishme për të dhe shpeshherë këshillohet të qëndrojnë edhe në një martesë të keqe, sepse divorci është stigmatizuar, nuk ka arsim të mjaftueshëm dhe as qasje në tregun e punës, gruaja nuk do të trashëgojë pronë, tokë dhe të holla dhe prej saj pritet bindje e nënshtrim në radhë të parë.¹. Këtu konsiderohet se:

- Femrat janë shumë emocionale, shumë më tepër se meshkujt. Megjithatë, ato nuk e kuptojnë vetminë e thellë.
- Burrat janë racionalë dhe logjikë. Megjithatë, ata nuk mund ta kontrollojnë veten kur një grua e "udhëheq" ose "e tundon".
- Burrat natyrisht kanë nevojë të veprojnë në mënyrë agresive, kështu që nuk mund t'i fajësoni ata kur grinden ose thyejnë gjërat. Megjithatë, supozohet se ata janë më të përshtatshëm për të qenë udhëheqës sesa gratë.
- Femrat janë hysterike dhe irracionale. Megjithatë, ato duhet të kujdesen për caktimin e të gjitha ekzaminimeve të mjekut, të rrisin fëmijët dhe të kujdesen për shtëpinë.
- Puna e një amvise nuk është e vështirë dhe gratë duhet të jenë të lumtura për ta bërë atë ndërsa bashkeshorti i tyre fiton. Megjithatë, burrat nuk do të bëjnë punët e shtëpisë edhe kur të dy punojnë, madje edhe kur ai është partneri që qëndron në shtëpi.
- Gratë janë të zemëruara dhe hakmarrëse. Megjithatë, meshkujt janë ata që përdorin dhunën kur u thuhet "jo".

Dhe shumë e shumë moskonsistenca të tjera. Megjithatë, ka vetëm një qëndrueshmëri të brendshme në patriarkalizëm: ajo u sjell dobi burrave. Duke pasur parasysh natyrën e sistemit në të cilin jetojmë, Klubi i Emancipimit mund të ofrojë shumë për gratë në Kosovë sot. Është e nevojshme që femrat e reja në Kosovë të vazhdojnë të përvetësojnë mjete në rrugën e tyre drejt emancipimit, të kuptojnë rolin e tyre në përparimin shoqëror të komuniteteve të tyre, të hedhin dritë mbi specifikat e perspektivës së femrës në shumë probleme. Në fund, është e

¹Sejdija, B. (29/04/2020) Gratë nga Kosova të ndara mes familjes dhe karrierës. Më shumë për këtë temë në [kete link](#).

nevojshme që ata të kuptojnë se gjinia është karakteristika më e rëndësishme, dhe kur gjërat si kombësia, feja apo kultura (dhe Kosova është shembull i mrekullueshëm për këtë sepse ka shumë komunitete) i ndajnë ato, gjinia është ajo që i afron - **përvoja femërore i afron ato.**

The background features a central white rectangular area with a faint, light blue floral pattern. This is set against a larger background of soft, golden-brown marbled textures. The corners are adorned with detailed watercolor-style illustrations of blue and pink flowers, green leaves, and small blue berries.

Gratë dhe gjinia

Socializimi gjinor

Është e qartë për ne se dallime midis grave dhe burrave ekzistojnë. Qoftë nga Ballkani, Evropa apo Azia. Dhe jo vetëm ato biologjike, të cilat reflektohen në sisteme të ndryshme riprodhuese, hormone dhe forcë muskulore, por situata është e tillë që edhe ato sociale krijohen në bazë të dallimeve biologjike. Shoqëria i trajton gratë dhe burrat ndryshe, ka pritshmëri të ndryshme prej tyre, u cakton role të ndryshme, i vlerëson ndryshe, i shpërblen dhe i ndëshkon për gjëra të njëjta. Sa më rezistente të jetë një shoqëri ndaj ndryshimit (dhe Kosova është me të vërtetë e tillë, sepse në të procesi i transformimit dhe tejkalimit të tradicionalizmit është si një lumë - është shumë i ngadalshëm dhe shpesh duket se në të vërtetë vetëm qëndron ende në një vend), aq më e vështirë është t'i rezistosh forcat e gjinisë, socializimin gjinor dhe rolin. Në Kosovë, presionet joformale, si dënimet dhe mosmiratimet, janë të forta, që është rasti me komunitetet që nuk janë mjaftueshëm të hapura dhe fleksibël. Dhe cila është rrënja e këtyre dallimeve? A janë këto predispozita të lindura? A është shoqëria ajo që na kushtëzon?

Ka shumë teori që shpjegojnë këtë fenomen. Ne do të mbështetemi në një teori sociologjike - teorinë e roleve gjinore²respektivisht teorinë e socializimit gjinor, e cila përmes dy proceseve - brendësismit dhe vetëvlerësismit, çon në faktin se dallimet biologjike midis grave dhe burrave ndërtohen mbi diferencimin e tyre shoqëror përmes procesit të të mësuarit të roleve gjinore.

Rolet gjinore janë të dukshme dhe të prekshme edhe para lindjes së një fëmije. Prindërit kanë një sërë pritshmëri nga fëmija i tyre, kështu që ata lyejnë dhomën e tij të gjumit me një ngjyrë të caktuar, blejnë lodra dhe gardërobë në përputhje me rrethanat. Edhe para se fëmija të lindë, shumë pritshmëri sociale e presin fëmijën. Dhe kur ai lind, procesi i socializimit gjinor me të vërtetë fillon. Këto pritshmëri të ndryshme të prindërve dhe të gjithë shoqërisë materializohen fillimisht përmes ngjyrave, lodrave, pritjeve të sjelljes, interesave, ndihmës në punët e shtëpisë, zhvillimit të aftësive jetësore, lirive, madje edhe të drejtave që ata do të kenë më vonë në jetë. Dhe sa më rezistente të jetë një shoqëri ndaj ndryshimeve, siç është rasti në Kosovë, aq më e madhe është sfida për t'u rezistuar forcave të socializimit gjinor. Këtu presionet joformale, zakonisht në formën e dënimit dhe mosmiratimit të mjedisit, janë shumë të forta.³

²Identiteti gjinor dhe socializimi gjinor: midis ngjyres roze dhe kalter. (11.03.2024). Psikologjia sociale. Mund të gjeni më shumë rreth identitetit gjinor dhe socializimit gjinor në [kete link](#).

³Dobranja, D. etj. Analiza gjinore: Një pasqyrë e shumëanshme e drejtësisë gjinore në Kosovë. Më shumë në [kete link](#)

Ngjyrat. rozë për vajzat, kalter për djemtë. Ajo është futur tek ata që nga lindja dhe janë mësuar të pranojnë se roza është një ngjyrë e butë, se është ekskluzivisht për vajzat dhe jo për djemtë. Megjithatë, ngjyrat nuk kanë gjini. Ngjyrat janë ngjyra.

Lodrat. Vajzave dhe djemve u jepen lodra të ndryshme në moshën më të hershme. Vajzat marrin kukulla për t'u kujdesur për to (dhe kështu mësojnë rolin e ardhshëm të një nëne të kujdesshme), marrin barbi, komplete kuzhine plastike (ku mësojnë rolin e ardhshëm të një amvise). E përbashkëta e këtyre lodrave është se ato janë pasive, se përmes lojës vajzat përgatiten për rolet që do të marrin si të rritura dhe u ofrohet një pamje e kufizuar se çfarë mund të bëhen kur të rriten. Nga ana tjetër, djemtë marrin tulla shumëngjyrëshe që mund t'i mbledhin në forma të ndryshme, t'i ndërtojnë dhe krijojnë, të marrin makina dhe figura super heronj ose ushtarësh. Dhe lodrat i përgatisin djemtë për rolet që do të marrin më vonë në jetë dhe u ofrojnë atyre një pamje të kufizuar se çfarë mund të jenë kur të rriten. Dallimi është "vetëm" se lodrat i shtojnë ato të jenë aktive, të lëvizin, të mendojnë dhe t'i referohen zgjidhjes logjike të problemeve, gjë që vajzat rrallë inkurajohen ta bëjnë gjatë lojës dhe rritjes.

Pritshmeritë dhe sjelljet. Loja e djemve shpesh përfshin ndotjen, grisjen e tyre. Ata inkurajohen të jenë aktivë dhe të lirë. Vajzat, nga ana tjetër, kritikohen shumë më shpesh nëse e bëjnë këtë. Garderoba e femrave është kufizuese, nuk ka xhepa, theksi vihet gjithmonë te pamja dhe prezantimi, jo te komoditeti. Vajzat me funde nuk mund të kërcëjnë dhe të vrapojnë. Ato mund të ulen në mënyrë pasive dhe të shikojnë djemtë ndërsa ata luajnë lirshëm.

Punët e shtëpisë. Vajzave u mësohet që në moshë shumë të hershme, që në moshën 10-vjeçare, sidomos në mjedise tradicionale si tonat, si të ndihmojnë nënat e tyre në punët e shtëpisë, të bëjnë kafe, të lajnë enët dhe të gatujnë me to. Djemtë nuk janë të ngarkuar me këto punë, ata ndjekin shembullin e baballarëve të tyre që rrallë marrin pjesë në punët e shtëpisë. Kur bëhet fjalë për punët e shtëpisë, djemtë mësojnë shumë herët se nëna e tyre do të kujdeset për ta dhe kur të rriten, gruaja e tyre e merr atë rol.

Këto shembuj të socializimit gjinor na tregojnë se djemtë dhe vajzat jetojnë në botë ku zbatohen rregulla të ndryshme, ku ata do të trajtohen ndryshe dhe do të kenë liri të ndryshme. Socializimi gjinor ndodh përmes dy proceseve. Së pari, ne pranojmë "rregullat e lojës" të imponuara sepse kështu na thonë prindërit, sepse kështu na thotë shoqëria dhe sepse kemi frikë se do të sanksionohemi nëse dalim jashtë komizës që na është dhënë. Ne pranojmë, si vajza, të veshim fustane dhe të mbledhim fotografi, edhe pse mund të mos duam, por kështu duhet të jetë. Ne i pranojmë të gjitha rregullat sepse e dimë se shoqëria do të na ndëshkojë nëse nuk i pranojmë ato. Këto sanksione janë më së shpeshti në formën e mosmiratimit nga mjedisi. Ju kujtohet vajza në klasën tuaj që i lidhte gjithmonë flokët dhe i pëlqente të luante futboll me djemtë. Ajo ishte një "mashkullorë". Djali që nuk i pëlqente

sportet dhe më së shumti rrinte me vajza ishte “i feminizuari”. Ne i kemi përqesh ata sepse nuk e kuptuam se është krejtësisht në rregull të kesh sjellje dhe pritshmëritë që nuk përputhen plotësisht me gjininë. Dhe se kjo i bënte ata të ndryshëm, por jo në mënyrë negative. Ata me lehtësi kane dalur nga rolet e imponuara gjinore dhe në vend që ta lavdëronim këtë, ne i perqeshnim e i komentonim. Thjesht kjo tregon se sa të fuqishme janë forcat e socializimit gjinor. Duket se në mjediset tradicionale, siç është Kosova, është më e vështirë t'u rezistosh këtyre forcave. Këto ndarje janë ndoshta më të dukshme në një pasdite të së dielës kur mund të takoni vetëm burra në rrugët e Mitrovicës jugore. Ose në koridoret e Shkollës së Mjekësisë në veri të Mitrovicës, ku më së shpeshti mund të takosh vajza. Ndarjet tipike për një shoqëri tipike tradicionale.

Një shembull i një stereotipi gjinor

Është thënë edhe më parë, por ideja që gratë lejohen të jenë të lëndueshme dhe të tregojnë emocionet e tyre ndërsa burrat nuk mundën, nuk ka kuptim. Kostoja e aftësisë së grave për të "treguar emocionet e tyre" është se njerëzit mendojnë se ne jemi të paarsyeshëm dhe të dobët. Njerëzit kanë treguar sinqerisht se mendojnë se gratë nuk duhet të jenë në pozitat e pushtetit, sepse emocionet tona mund të na çojnë në fillimin e një lufte. Kështu thonë njerëzit që nuk duan gratë në pozita. Arsyeja e vetme që na lejohet të jemi " të lëndueshme " është sepse ne jemi tashmë të prezantuara si të dobëta, kështu që NATYRISHT që do të qajmë. Ndjentat tona nuk janë falas (autor).

Si të tejkalojmë stereotipet gjinore?

Reduktimi i efekteve të socializimit gjinor kërkon një qasje afatgjatë dhe gjithëpërfshirëse që përfshin të gjitha nivelet e shoqërisë, nga familja dhe shkolla e deri te komuniteti më i gjerë. Kosova është një mjedis thellësisht tradicional, por çdo ndryshim është fillimisht çështje individuale dhe më pas përpjekje kolektive për të ecur përpara. Duke qenë se socializimi gjinor fillon që në moshë të re, katalizatori kryesor i tij është familja, e ndjekur nga shkolla. Është pikërisht në ato vende që është e nevojshme të kërkojnë mënyra për të tejkaluar stereotipet. Është e nevojshme t'u sigurohet fëmijëve një shumëllojshmëri zgjedhjesh kur bëhet fjalë për ngjyrat, aktivitetet dhe lodrat. Që përmes librave dhe përmbajtjeve argëtuese që shfaqin personazhe të ndryshëm, fëmijët të mësojnë diçka më shumë për rolet e tyre. Është e rëndësishme t'u lejohet fëmijëve lirinë e zgjedhjes në lojë, aktivitete

dhe interesa, pavarësisht nëse tradicionalisht janë femra apo meshkuj. Në këtë mënyrë, në vend që të kufizohen, fëmijët do të zhvillojnë talente, aftësi dhe interesa të ndryshme. Prindërit dhe mësuesit duhet të jenë shembuj pozitivë në promovimin e barazisë gjinore. Nëse duam që brezat tanë të ardhshëm të jenë më empatikë, më tolerantë, më të aftë dhe më të mirë se ne - duhet t'u mësojmë atyre këtë.

The background features a light cream color with a subtle marbled pattern in shades of beige and gold. The corners are adorned with delicate watercolor-style floral illustrations, including blue and pink flowers with green leaves and small blue berries. The overall aesthetic is soft and elegant.

Gratë udhëheqin

Gratë dhe feminizmi

Para se të hedhim një vështrim më të afërt se si gratë filluan të dalin nga sfera e shtëpisë dhe familjes, ku u vendosën në bazë të stereotipeve gjinore, në domenin e publikut dhe politikës, është e nevojshme të flitet për feminizmin, i cili u mundësoi ta bëjnë këtë. Feminizmi është teoria dhe praktika e çlirimit të grave. Ka qark shumë këndvështrime të ndryshme, kaq shumë mënyra të ndryshme për të përcaktuar luftën e grave, por përkufizimi i ofruar kap më së miri thelbin e feminizmit. Të gjitha rrymat kryesore në feminizëm theksojnë aspekte të ndryshme të çlirimit të gruas, megjithatë është e rëndësishme të dihet se çfarë kanë mundësuar të gjitha këto feminizma (liberalë, radikalë, ekologjikë) për gratë. Si e bënë politiken personale, nxorren në sipërfaqe probleme si puna e papaguar e femrës, dhuna (familjare) ndaj grave, seksualiteti femëror etj. Kosova përbëhet nga komunitete të ndryshme, ato ndryshojnë në kulturë, kohëzgjatje, kujtime, gjuhë, por përtej këtyre dallimeve ka një marrëveshje të heshtur: feminizmi është i nevojshëm për gratë në Kosovë.

Lufta për çlirimin e gruas u zhvillua në valë. Vala e parë ndodhi në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të. Qëllimi ishte krijimi i mundësive për gratë, me fokus të veçantë në të drejtën e votës. Rezultati i këtyre betejave ishte fitimi i të drejtës së votës për gratë në Amerikë. Vendi i fundit në Evropë që u dha grave të drejtën e votës ishte Zvicra (1973). E drejta universale e votës e grave ende nuk ekziston sepse në shumë vende si Afganistani apo Pakistani ka një rezistencë të madhe ndaj pjesëmarrjes së grave në politikë. Edhe në Kosovë, e cila është një mjedis thellësisht tradicional, e drejta e grave për të votuar nuk është një gjë universale. Në komunitetin shqiptar, kur gratë votojnë, shpesh është pjesë e procesit të "votimit familjar" ku gruaja voton ashtu siç e udhëzon burri ose babai i saj, dhe shpesh gratë shkojnë në qendrat e votimit vetëm pasi të kenë mbaruar detyrat e tyre shtëpiake. ose nuk mbëmijnë fare). Nëse janë analfabetë, atëherë zakonisht votojnë sipas parimit të votimit familjar dhe shpesh ndodh që vota e tyre të "vidhet".⁴ Gjithashtu, ato nuk votojnë në të njëjtat vende me gratë serbe, sepse komuniteti serb rregullisht i bojkoton zgjedhjet në Kosovë. Gratë nga komuniteti serb votojnë në zgjedhjet serbe, por shpesh nën ndikimin e partisë dominuese politike, kështu që edhe atyre në një farë mënyre u privohet e drejta për të votuar lirisht dhe sipas dëshirës. Situata me pjesëmarrjen e grave në nivelin më themelor politik - në procesin e votimit në Kosovë na tregon se pavarësisht nga kombësia, feja dhe kultura, gratë ende përballen me pengesa për të marrë pjesë në proceset politike demokratike.

⁴Jašari, S. (06.06.2017). Mijëra gra pa të drejtë vote në zgjedhjet e së dielës. Kosova 2.0. Më shumë në [kete link](#)

Vala e dytë filloi në vitet '60 dhe vazhdoi deri në vitet '90. Në këtë fazë, çështjet kryesore ishin seksualiteti dhe të drejtat riprodhuese. Feministët folën për gratë si një klasë shoqërore dhe shpikën shprehjen "personalja është politike". Ato kanë bërë përpjekje për të çliruar shoqërinë nga lart poshtë nga seksizmi, duke kritikuar gjithçka që ata e shihnin si problematike - nga filmat vizatimorë për fëmijë deri te nivelet më të larta të qeverisë.

Vala e tretë filloi në mesin e viteve '90. Një nga aspektet më interesante ishte se shumë feministe të reja ripërqafuan atë që paraardhësit e tyre refuzuan: grimin, takat e larta, duke besuar se një grua mund të dukej bukur dhe të ketë tru në të njëjtën kohë. Përveç kësaj, kjo valë shënoi gjithashtu një ndjenjë të fortë të vetëdijes në lidhje me paragjykimet, privilegjet dhe dinamikat e pushtetit të dikujt.

Ne jetojmë në valën e katërt. Ajo përcaktohet nga përdorimi i teknologjisë. Teknologjia shihet si një mjet që lejon gratë të ndërtojnë një lëvizje të fuqishme në mediat sociale. Kjo valë filloi dhjetë vjet më parë, dhe fokusi është në ngacmimet seksuale, kultura e përdhunimit, *turpërimi i trupit (body shaming)* dhe tema të ngjashme. Një komponent kyç ishte përdorimi i mediave sociale për të theksuar dhe adresuar këto çështje. Ky seksion i shkurtër i valës së feminizmit na jep vetëm një skicë për të kuptuar më mirë luftën e grave për barazi. Përsëri, lufta e grave në Kosovë është shumë më komplekse, me rezistencë të madhe nga komunitetet patriarkale dhe tradicionale dhe ku problemet "më të mëdha" si kombet dhe nacionalitetet dhe konfliktet e bazuara në to janë vënë në plan të parë dhe ku ka qenë gjithmonë jashtëzakonisht e vështirë të gjeni kohë për luftën për përmirësimin e pozitës së gruas. Megjithatë, gratë nga Kosova, para dhe gjatë luftës luftuan për agjendat dhe synimet e tyre politike në kontekstin e përparimit të tyre shoqëror.

Kjo luftë e gjatë e gruas për çlirim solli ndër të tjera barazinë formale-juridike të grave dhe burrave në Kosovë. Barazia formale-juridike nënkupton që të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit dhe se askush nuk diskriminohet para ligjit. Kushtetuta më së shumti e garanton këtë. Dhe në një farë mënyre, kjo është e vërtetë, burrat dhe gratë janë të barabartë përpara ligjit. Por jo në të gjitha vendet. Nga shembujt që kam përmendur tashmë, shihet qartë se në Kosovë barazia para Kushtetutës shpesh qëndron vetëm si shkronjë në letër. Kjo është pikërisht arsyeja pse është e rëndësishme të arrihet barazia sociale. Dhe nuk është vetëm imperativ moral, por do të sillte edhe shumë ndryshime pozitive sociale në Kosovë. Barazia sociale e grave dhe burrave në Kosovë është e rëndësishme për disa arsye: arritja e saj është e një rëndësie kyçe për arritjen e një shoqërie të drejtë të barabartë, do të mundësonte zhvillim dhe prosperitet ekonomik, ulje të varfërisë dhe rritje të të ardhurave kombëtare dhe do të ishte themeli i një shoqërie të qëndrueshme.

The background features a light cream color with a subtle marbled pattern in shades of gold and brown. It is adorned with delicate floral illustrations in blue and pink, including large flowers and smaller berries, scattered in the corners. A faint, large-scale floral watermark is visible in the center.

Gratë dhe politika

Gratë përbëjnë 51% të popullsisë së përgjithshme. Vetëm 26% e jetës politike përbëhet nga gra⁵.

Në Kosovë, peizazhi politik nuk është shumë i larmishëm gjinor, gjë që pasqyron situatën në nivel global. Gratë rrallë gjenden në pozita udhëheqëse në ministri dhe komuna, dhe përqindja e grave në mbledhjen e Kuvendit mezi kalon 30% (që është kuota ligjore). Shumica e partive nuk parashikojnë një kuotë gjinore në strukturën e tyre drejtuese, burrat zakonisht kryesojnë dhe një numër shumë i kufizuar vendesh për anëtarët e zyrës përfaqësuese janë aktualisht të zëna nga gratë.⁶

Këtu parashtrohet pyetja në mënyrë të justifikuar: "Pse gratë hasin në probleme me hyrjen në politikë dhe qëndrimin në të?" Përgjigja për këtë pyetje është shumë komplekse dhe shkaqet e kësaj gjendjeje janë të dyfishta. Nga njëra anë, ka disa arsye të brendshme pse ata merren me politikë. Së pari, gratë adoptuan rolet gjinore dhe pritshmeritë sociale. Politika është pothuajse një klub ekskluziv mashkullor, ndërsa shtëpia është një vend i rezervuar për femrat. Në Kosovë, ku lufta kundër stereotipeve gjinore është e vështirë, gratë kanë më pak gjasa të angazhohen në profesione tradicionale mashkullore, siç është politika. Përveç kësaj, kur gratë hyjnë në politikë, ato janë të ekspozuara ndaj një shkalle më të madhe të shqyrtimit publik dhe mbulimi mediatik karakterizohet nga stereotipizimi serioz i grave, si dhe nga zbatimi i standardeve të dyfishta në raport me burrat.⁷ Gratë në politikë do të kenë gjithashtu më shumë gjasa të gjykohen për neglizhencën e roleve të tyre tradicionale si nëna dhe bashkëshorte duke hyrë në politikë. Së fundi, këto gra janë shumë shpesh cak i dhunës psikologjike të ushtruar përmes mediave dhe rrjeteve sociale dhe shpeshherë janë viktimat e dhunës fizike. Ndërsa arsyet e brendshme i referohen asaj që i dekurajon vetë gratë të hyjnë në politikë, arsyet e jashtme i referohen mënyrës sesi shoqëria i trajton ato. Këtu përfshihet një gamë e gjerë paragjykimesh dhe stereotipash për gratë, me të cilat shoqëria i shënon si të papërshtatshme për jetën politike, pastaj diskriminimin që hasin, si dhe dhunën. Së fundi, një faktor i rëndësishëm është barra e dyfishtë që u është ngarkuar: xhonglimi mes aktiviteteve familjare dhe atyre politike. Nëpërmjet prizmit të pjesëmarrjes së grave në politikë, mund të shohim shumë efekte negative të patriarkalizmit. Në Kosovë, gratë janë ende të ngarkuara me rolin e "kujdestarit" (të fëmijëve, të bashkëshortit dhe anëtarëve më të vjetër të familjes) dhe me përgjegjësi dhe punë të tjera "tradicionalisht femërore", të gjitha pa shumë

⁵Facts and figures: Women's leadership and political participation. UNWOMEN. Më shumë detaje rreth pjesëmarrjes së grave në politikë mund të gjeni në [kete link](#).

⁶Gratë në politikë. (pa)barazia gjinore në politikë dhe në procesin e vendimmarrjes. (2019). Më shumë në [kete link](#).

⁷Leinart Novosel, S. (2010). Stereotipet gjinore, paragjykimet dhe diskriminimi ndaj grave në politikë. Përmbledhje e të Drejtave të Grave. Më shumë në [kete link](#).

mbështetje nga burrat. Prandaj, ata nuk janë as të motivuar të hyjnë në politikë sepse do të përbënte një barrë shtesë për ta⁸.

Si të kemi më shumë gra në poste drejtuese?

Për të mundësuar pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë, propozohen shumë politika progresive afirmative, si rritja e kuotave për gratë në listat zgjedhore ose rezervimi i vendeve për gratë në parlament. Megjithatë, lind pyetja nëse politikat progresive të veprimit afirmativ janë vërtet progresive apo jo? A do të thotë cilësia sasi? Si e kuptojmë sjelljen e grave në politikë sot? Merrni për shembull Vjosa Osmanin dhe Ana Brnabić, të cilat janë në poste shumë të larta qeveritare. A avokojnë ato mjaftueshëm për të drejtat e grave, hapin dhe zgjidhin çështjet e grave, apo thjesht ndjekin politikat e partive të tyre? Nga ana tjetër, pa masa progresive afirmative, shumë pak gra do të ishin fare të motivuara për të hyrë në politikë dhe as partitë politike nuk do t'i propozonin gratë si lidere të tyre.

Ekzistojnë gjithashtu disa rekomandime të përgjithësuara që nënkuptojnë ndryshime sociale. Për shembull, punoni për eliminimin e paragjyqimeve me bazë gjinore dhe rishqyrtimin e roleve gjinore. Gjithashtu, nevojitet edhe puna për edukimin politik të grave, e cila do të organizohej në nivel lokal dhe qendror dhe do të përfshinte si aktorët shtetërorë ashtu edhe ata nga shoqëria civile.

⁸Kovačević, N. (12/02/2024) Gratë në politikë: Gjinia dhe gjinia si e metë. *Revistë e re*. Më shumë për këtë temë në [kete link](#).

The background features a light cream color with intricate marbled patterns in shades of gold and brown. The corners are adorned with delicate watercolor-style illustrations of blue and pink flowers, green leaves, and small blue berries. The overall aesthetic is soft and elegant.

Gratë dhe konflikti

Perspektiva e grave në zgjidhjen e konflikteve

Në janar të këtij viti, organizata jonë CASA priti studentë të programit të studimeve master për të drejtat e njeriut të aplikuar në Vjenë. Nuk u befasuam kur të ftuarit tanë doli të ishin vajza. Vetëm vajza. Doli se takimi tregoi se vajzat me sa duket kanë më shumë ndjeshmëri, empati dhe aftësi për të përballuar problemet. Dhe me të vërtetë, studimet e paqes më së shpeshti tërheqin vajza të reja. Një dekadë më parë, The Guardian shkroi se si hulumtimi tregoi se kur gratë përfshihen në procesin e ndërtimit të paqes, ka një shans 24% më të madh që dhuna të ndalet brenda një viti. Konsiderohet se gratë kanë rëndësi thelbësore sepse në procesin e ndërtimit të paqes ato fokusohen më shumë në problemet sociale dhe jo vetëm në atë që do të kënaqë palët kundërshtarë. Ky hulumtim tregoi gjithashtu avantazhin e përfshirjes së grave në proceset e paqes, por edhe se vetëm përfshirja nuk mjafton.

Lindin pyetjet: "A janë gratë më të prirura për paqe se burrat?" Dhe, "A tregojnë gratë, në konfliktet ndërkombëtare, më pak armiqësi se burrat"? Me mendje të shëndoshë mund të supozojmë se është kështu. Dhe hulumtimet kanë treguar se gratë janë më të shqetësuara për mundësinë e luftimit të luftërave të ardhshme në krahasim me burrat, se ndjeshmëria (një tipar që shpesh lidhet me gratë) është një tregues shumë i mirë i arritjes së kompromisit në konflikte. Kjo çështje është shumë e afërt dhe e njohur për Kosovën. Është një territor praktikisht e gjithë historia e të cilit është e shënuar nga konfliktet etnike Edhe pse gratë rrallë marrin pjesë në luftë si luftëtare, ato janë më të prekura dhe më së shpeshti nga pasojat e konfliktit të luftës. Edhe këtu, gratë veçohen nga proceset e paqes, megjithëse pranohet se gratë që vijnë nga vendet e prekura nga lufta mund të ndihmojnë në mënyrën më të mirë në procesin e ndërtimit të paqes. Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ndër të tjera⁹:

- *U bën thirrje vendeve anëtare të sigurojnë praninë e shtuar të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në institucionet dhe mekanizmat kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve;*
- *U bën thirrje të gjitha palëve të përfshira të miratojnë një perspektivë gjinore gjatë negociatave dhe marrëveshjeve për zbatimin e paqes, duke përfshirë, ndër të tjera: (a) nevojat e veçanta të grave dhe vajzave gjatë riatdhesimit dhe zhvendosjes dhe gjatë rehabilitimit, riintegritit dhe rindërtimit pas konfliktit; (b) masat që mbështesin iniciativat lokale të grave për paqen dhe proceset lokale për zgjidhjen e konflikteve dhe që*

⁹Kosova nuk është anëtare e OKB-së, por përmes Konventës së Stambollit u përpoq ta integrojë Rezolutën 1325 në Kushtetutë.

Rezoluta 1235 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mund të gjendet e plotë në linkun [Resolution 1235 \(unscr.com\)](https://www.un.org/press/docs/2000/200006201235.html).

përfshijnë gratë në të gjithë mekanizmat për zbatimin e marrëveshjeve të paqes; (c) masat që do të sigurojnë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave, veçanërisht kur ato lidhen me kushtetutën, sistemin zgjedhor, policinë dhe gjyqësorin.

Konsiderohet se ky dokument “shkon dorë për dorë me përkushtimin ligjor dhe politik të Kosovës për barazinë gjinore”.¹⁰, megjithatë letra në letër shpesh mbetet pikërisht ajo. Angazhimi për barazinë gjinore në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, duke përfshirë proceset e paqes, duhet të shoqërohet me ndryshime të prekshme dhe përpjekje për të arritur barazinë sociale midis grave dhe burrave. Këtë ide më sinqerisht e shprehu Igo Rogova, drejtoreshë ekzekutive e Rrjetit të Grave të Kosovës, duke theksuar se është mërzhitur nga raportet dhe konferencat ku debatohet për Rezolutën 1235 dhe se ajo që nevojitet urgjentisht është veprim.¹¹.

Si t'u mundësojmë grave që të jenë pjesë e proceseve të paqes?

Për të vendosur paqen afatgjatë në territoret me histori të gjatë konflikti etnik, siç është Kosova, është e nevojshme të institucionalizohet barazia gjinore në atë mënyrë që do të siguronte pjesëmarrjen e përhershme të grave në zbatimin e planit të paqes. Politika të tilla do të inkurajonin gjithashtu gratë që të kapërcejnë viktimizimin (dhe gratë janë viktimat më të zakonshme civile të luftës, si dhe fëmijët) dhe të jenë në pozita që do të vendosin një paqe më të qëndrueshme. Kjo nënkupton përpjekje sistematike në nivele të shumta, duke përfshirë institucionet politike, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile. Para së gjithash, është e rëndësishme të sigurohet që gratë të përfshihen në mënyrë aktive në të gjitha fazat e procesit të paqes duke vendosur kuota në ekipet negociuese. Në mënyrë që të sigurohet që ato vende në ekipe të zënë gra vërtet cilësore, është e nevojshme të organizohen trajnime për gratë mbi aftësitë e lidërshpit, negociatat për paqen, si dhe të ofrohet mbështetje për edukimin e lidereve dhe aktivisteve femra lokale. Në këtë mënyrë mund të sigurohet roli i përhershëm i gruas në proceset e paqes, gjë që do të kontribuojë në krijimin e zgjidhjeve paqësore më gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të drejta.

¹⁰Szynyog, T. Ne duhet t'i fuqizojmë gratë dhe t'i angazhojmë ato si agjente aktive të paqes. EEAS. Më shumë në [kete link](#)

¹¹Rrjeti i Grave të Kosovës. 1325: Fakte dhe tregime. Raporti i plotë është në dispozicion në [kete link](#)



Gratë dhe mediat

Portretizimi stereotipik i grave

Me popullaritetin e rrjeteve sociale, është ritur aftësia e njerëzve për të shprehur dhe ndarë pikëpamjet, opinionet, dëshirat, synimet dhe ëndrrat e tyre me të gjithë botën. Interneti është një medium demokratik dhe ndonëse kjo duhet të jetë natyrshëm veçoria e tij më pozitive, kjo nuk është ashtu. Në Kosovë ka rreth 1.6 milionë përdorues të internetit në total dhe afërsisht 930 milionë përdorues të rrjeteve sociale¹². Kur të gjithë mund të shprehin mendimin e tyre, lind pyetja, a janë mendimet e të gjithë njerëzve diçka që ne kemi nevojë dhe duam të dëgjojmë? Toksiciteti i rrjeteve sociale mund të shërbehet më së miri nga një eksperiment të vogël që Twitter kreu disa vite më parë. Gjegjësisht, u krijua një bot femër me aftësinë për të mësuar dhe adoptuar gjëra të reja përmes ndërveprimeve me përdoruesit e tjerë. Në vetëm pak orë, ai bot adoptoi dhe shprehu qëndrime jashtëzakonisht mizogjene, raciste dhe naziste. Interneti karakterizohet nga një dualitet: ai luan një rol të rëndësishëm në valën e katërt të feminizmit. Është jashtëzakonisht i dobishëm në fushatat e grave, si një mjet i rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit dhe organizimin e ngjarjeve dhe protestave, siç është protesta e fundit në Prishtinë. Protesta u organizua nga Kolektivi për Mendimin Feminist, duke kërkuar sigurinë e vajzave dhe grave, pas përdhunimit të një vajze.¹³ Me këtë rast rrjetet sociale janë shfrytëzuar për grumbullimin e njerëzve në protestë, por edhe për përhapjen e mesazhit në mbarë Kosovën. Nga ana tjetër, natyra e tij demokratike e ka bërë internetin një vend të pasigurt për gratë dhe vajzat. Në nivel global, dhuna në internet, ngacmimi seksual dhe diskriminimi janë në rritje¹⁴.

Por le të shohim mediat tradicionale. Duket se edhe ata janë ende toksikë në shumë mënyra, sepse edhe ata kanë mënyrat e tyre të përhapjes së pabarazisë gjinore, stereotipeve dhe paragjykimeve gjinore. Nëse shikojmë reklamat e detergjenteve, më së shpeshti femrat shfaqen në rolin e nënave apo amvisave, duke u kënaqur duke bërë punët e shtëpisë me vajzat e tyre. Meshkujt shfaqen më shpesh në reklama për produkte argëtuese, si për shembull ndnjë pije alkoolike. Por ky nuk është i vetmi rol që media i cakton një femre. Nëse ajo nuk është një nënë dhe shtëpiake modeste, atëherë seks simbol dhe objekt. Reklamat janë të pranishme kudo dhe zakonisht shërbejnë për të normalizuar disa sjellje dhe pritshmëri që kemi nga gratë dhe burrat. Prandaj, nuk mund të themi se gratë nuk

¹²Datareportal. Digjital 2023: Kosovo: Kosovë. Mund të gjeni më shumë rreth trendeve të përdorimit të pajisjeve dhe shërbimeve digjitale në Kosovë për vitin 2023 në [kete link](#).

¹³T. Bujar. (14.03.2024). “Sa herë duhet të protestoj për të njëjtën gjë? Radio Evropa e Lirë. Më shumë për këtë temë në [kete link](#)

¹⁴CoE. Internet content and equality between men and women. Detaljnije možete čitati na linku Sample, I. (12.3.2020) Internet is not working for women and girls, says Berners-Lee. The Guardian. Mund të lexoni më shumë në [kete link](#)

janë të dukshme në media. Problemi këtu është se si paraqiten ato. Gratë në media paraqiten si simbole dhe tendenca. Janë të dëshirueshme, ideale, nuk kanë asnjë gram celulit, kanë flokë të gjatë dhe janë gjithmonë të buzëqeshur, edhe në reklamën për peceta higjienike. Brezat e vajzave në Kosovë rriten me imazhe të tilla dhe krijojnë një imazh jorealit dhe të kufizuar se çfarë është një grua dhe çfarë mund të jetë ajo. Vajzat adoptojnë këto modele - si të vishen, si të buzëqeshin, si të grimohen për të qenë femra të vërteta.

Një pasojë e rëndësishme e prezantimit stereotip të grave në media është vazhdimi dhe thellimi i pabarazisë gjinore dhe normave të dëmshme të bazuara në gjini. Media përforcon perceptimin social se gratë janë më pak të afta, më pak të rëndësishme ose të kufizuara në role dhe karakteristika të caktuara. Kur gratë prezantohen kryesisht si kujdestare, shtëpiake dhe nëna, kjo përforcon idenë se vlera e tyre qëndron kryesisht në marrëdhëniet e tyre me të tjerët dhe jo në vetveten, tiparet dhe aftësitë e tyre. Siç u përmend më lart, mungesa e portretizimit të nuancuar dhe të larmishëm të grave në media mund të ketë një ndikim negativ në vetëvlerësimin dhe aspiratat e grave. Kur ata shohin kryesisht përshkrime njëdimensionale ose stereotipike të grave, ato mund të përvetësojnë pritshmëritë dhe të perceptojnë potencialin e tyre si të kufizuar nga normat gjinore. Përfaqësimi i gruas në media, i cili është stereotip dhe njëdimensional, ndikon jo vetëm në perceptimet individuale, por edhe në thellimin e pabarazive me bazë gjinore në shoqëri.

Mënyra se si paraqiten gratë në media është një pasqyrim i diskriminimit të përgjithshëm shoqëror dhe stereotipeve. Dhe kur shikojmë strukturën e brendshme të medias, hasim të njëjtat modele patriarkale. Domethënë, pozitat e pronarëve dhe redaktorëve janë pothuajse gjithmonë burra. Nëpërmjet platformës *Media Ownership Monitor (MOM)*.¹⁵ e cila është një bazë të dhënash publike dhe e qasshme për pronësinë e mediave, mund të shohim se në Serbi dhe Kosovë çështja e pabarazisë gjinore në media paraqitet si një rrezik i madh. Situata është e njëjtë në të dyja rastet. Vetëm disa media kanë një politikë të brendshme që synon një përfaqësim të balancuar të grave në redaksi. Ngacmimi i gazetareve femra është i shpeshtë në të dyja mjediset, shumë raste njihen dhe raportohen, dhe objektivat e ngacmimeve janë më shpesh femrat sesa meshkujt. Pjesa e grave në pronësinë e medias kryesore është më pak se 30%, dhe e tillë është pesha e grave në mesin e themeluesve të mediave, si dhe në mesin e drejtuesve të lartë, si dhe në postet kryesore editoriale. Pra, ka ende gra në media, në pozitat e gazetares, fotoreporteres, redaktore, lektore, redaktore e të ngjashme. Por pozita e tyre është sigurisht larg idealit. Një hulumtim, “Gratë në media”, i cili u krye në Serbi dhe në territorin e Kosovës, tregoi se ka probleme të ngjashme në të dyja komunitetet:

¹⁵Media ownership monitor për Serbinë në [kete link](#).
Media ownership monitor për Kosovën në [kete link](#)

diskriminimi i grave në bazë të pamjes dhe moshës, sakrifikimi i jetës private për hir të punës, rastet e ngacmimeve seksuale, paga të ulëta¹⁶.

Si të tejkalohen këto probleme?

Zgjidhja e problemit në prezantimin mediatik të grave gjendet në burimet e atyre që thellojnë stereotipet gjinore. Në radhë të parë, vetëm gazetarët dhe profesionistët e medias duhet të punojnë në ngritjen e vetëdijes për pasojat e dëmshme të prezantimit stereotip të grave përmes trajnimeve dhe seminareve. Duke qenë se vetë përdoruesit janë krijuar të përmbajtjeve në rrjetet sociale, është e nevojshme të punohet në ngritjen e vetëdijes sociale për këtë problem në përgjithësi. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që praktikantët ekzistues të kritikohen nga vetë punonjësit e medias, si dhe nga politikanët të cilët duhet të përdorin platformën e tyre për të vënë në dukje problemet në përfaqësimin mediatik të grave. Është gjithashtu e rëndësishme të fitohet shikueshmëria në rrjetet sociale, kështu që hapja e grupeve apo faqeve të veçanta do t'u mundësonte grave të punësuara në media dhe që vijnë nga komunitetet serbe, shqiptare dhe të tjera të lidhen duke folur për problemet e grave në profesionin e tyre.

Në gjurmët e konkluzionit

Përmes këtyre katër temave, ne u përpoqëm të shqyrtojmë disa nga çështjet kryesore që shqetësojnë gratë sot në Kosovë. Jemi plotësisht të vetëdijshëm për mundësinë e mungesës së shumë temave të rëndësishme, por nuk e zvogëlojmë rëndësinë e tyre. Thelbi i çdo punëtorie ishte përvoja e grave në kontekstin e njërës prej temave të dhëna. Kështu arritëm në konkluzionin kryesor, që është sensi i shëndoshë, por ishte e nevojshme të arrinim së bashku. Gratë në Kosovë të nacionaliteteve të ndryshme, religjioneve, statusit social, arsimimit të ndryshëm, orientimit seksual, grave me ngjyra të ndryshme të flokëve dhe syve, zakone dhe qëndrime jetësore, të gjitha kanë diçka të përbashkët në thelb –është përvoja kolektive femërore: ajo ndahet nga të gjitha gratë individuale, është gjithçka që e bën një grua grua dhe ajo që e dallon atë nga një burrë në atë dikotomi. Kjo përvojë kolektive femërore i tejkalon të gjitha dallimet, etnike, fetare, kulturore dhe nevojën për të dëgjuar, shqiptuar dhe kuptuar është nevoja e çdo gruaje. Pra pikerisht aty duhet kërkuar potenciali për përparim shoqëror në përgjithësi dhe

¹⁶Women in media. Serbia and Kosovo. (2023). *Peaceful change initiative*. Ju mund të lexoni më shumë rreth këtij hulumtimi në [kete link](#).

ndërtimi i paqes në Kosovë si detyrë e veçantë. Përvoja e grave në Kosovë mund të kontribuojë ndjeshëm në ndërtimin e paqes në disa mënyra: duke sjellë një qasje më gjithëpërfshirëse dhe më të menduar për ndërtimin e paqes duke marrë parasysh perspektivat dhe nevojat e komuniteteve të ndryshme, duke promovuar jodhunën dhe duke theksuar vlerën e paqes, ato mund të çojnë në parandalim. dhunës dhe pajtimit. Së fundi, siç tregohet në tekst, përvoja e grave shpesh lidhet me luftën për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, dhe përmes aktivizmit, gratë punojnë për të promovuar të drejtat e njeriut të të gjithë qytetarëve të Kosovës, duke krijuar kështu bazën për një paqe të qëndrueshme. Në përgjithësi, përvoja e grave në Kosovë mund të jetë e një rëndësie jetike për ndërtimin e një paqeje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme që respekton nevojat dhe perspektivat e të gjithë qytetarëve, dhe mbi këtë bazë, bashkëpunimi ndërmjet aktivisteve femra nga Serbia dhe Kosova mund të vazhdojë. Integrimi i grave në proceset e paqes jo vetëm që forcon rolin e tyre në shoqëri, por gjithashtu kontribuon në qëllimin më të gjerë të arritjes së paqes dhe stabilitetit në Kosovë.

Literatura

- Sejdija, B. (29/04/2020) Gratë nga Kosova të ndara mes familjes dhe karrierës. Shkarkuar nga [linku](#).
- Dobranja, D. et alia. *Analiza gjinore: Një rishikim i shumëanshëm i drejtësisë gjinore në Kosovë* Shkarkuar nga [linku](#).
- Identiteti gjinor dhe socializimi gjinor: midis ngjyres roze dhe kaltër. (11.03.2024). Psikologjia sociale. Shkarkuar nga [linku](#).
- Jašari, S. (06.06.2017). Mijëra gra pa të drejtë vote në zgjedhjet e së dielës. Kosova 2.0. Shkarkuar nga [linku](#)
- Factsandfigures: Women’sleadershipandpoliticalparticipation. UNWOMEN. Shkarkuar nga [linku](#).
- Gratë në politikë. (pa)barazia gjinore në politikë dhe në procesin e vendimmarrjes. (2019). BIRN. Shkarkuar nga [linku](#).
- Leinart Novosel, S. (2010). Stereotipet gjinore, paragjykimet dhe diskriminimi ndaj grave në politikë. *Përmbledhje e të Drejtave të Grave*. Shkarkuar nga [linku](#).
- Kovačević, N. (12/02/2024) Gratë në politikë: Gjinia dhe gjinia si disavantazh. Revistë e re. Shkarkuar nga [linku](#).
- Rezoluta 1235 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Shkarkuar nga: [Resolution 1235 \(unscr.com\)](#).
- Szunyog, T. Ne duhet t'i fuqizojmë gratë dhe t'i angazhojmë ato si agjente aktive të paqes. EEAS Shkarkuar nga [linku](#)
- Rrjeti i Grave të Kosovës. 1325: *Fakte dhe tregime*. Shkarkuar nga [linku](#)
- Raporti i të dhënave. Digital 2023: Kosovë. Shkarkuar nga [linku](#).
- T. Bujar. (14.03.2024). “Sa herë duhet të protestoj për të njëjtën gjë? Radio Evropa e Lirë. Shkarkuar nga [linku](#)
- *Media ownership monitor* për Serbinë në [linkun](#).
- *Media ownership monitor* për Kosovën në [linkun](#).
- Women in media. Serbia and Kosovo. (2023). *Peaceful change initiative*. Shkarkuar nga [linku](#).

Video material për arsimim të mëtejshëm:

- [Girls Alone. Social experiment documentary.](#)
- [Boys Alone. Social experiment documentary.](#)
- [The Dark Side of Gender Stereotypes](#)
- [How to avoid gender stereotypes](#)

- [Why we have too few women leaders](#)
- [Women should represent women in media](#)

Libra për arsimim të mëtejshëm:

- Zaharijević, A. (2008). *Dikush tha feminizëm*. Heinrich Boll Stiftung: Novi sad
- Lerner, G. (1986). *The creation of patriarchy*. Oxford University Press: New York